

A COMPARISON OF KAFKA'S *THE TRIAL* AND CAMUS' *THE STRANGER*

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI²

¹*Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

²*Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians - Skopje*

e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk

Abstract

This paper will deal with the comparison of the two most important 20th-century world literature novels. The theme of Kafka's novel has its source in the sharp contrast between the protagonists and the reality surrounding which Kafka's characters are incapable of accepting. His novels and novels are dominated by the misunderstanding, the nightmare, the illusion, the anguish of God's silence. Kafka accuses in his works the inhuman bureaucratic social system and criticizes the justice system. The protagonist in the novel *The Trial* is a victim of the system and at the same time guilty as an integral part of the bureaucratic apparatus. The process against it is a perfect organization of actions and people, who arrest innocent people, fabricate meaningless processes.

On the other hand Albert Camu inextricably links his personal life, with the collective vicissitudes, in the name of man, of his absurd life on earth in search of truth and happiness. Camus' work begins with the existential problems of the absurd: he asserts that man is alone, surrounded by a state of eternal wretchedness: poverty, pain, injustice, violence create an unjustified wilderness around him. To avoid despair one must accept this situation with sobriety and must consciously struggle to affirm oneself and the „relentless greatness of life“.

Keywords: *Roman, Kafka, Camu, The Trial, The Stranger.*

Abstrakti

Në këtë punim do të trajtohet krahasimi i dy romaneve më të rëndësishme të letërsisë botërore të shekullit XX. Tema e romanit të Kafkës e ka burimin në kontrastin e thellë mes protagonistëve dhe realitetit që i rrethon, të cilin personazhet e Kafkës janë të paaftë ta pranojnë. Në novelat dhe romanet e tij mbizotëron moskuptimi, makthi, halucinacioni, ankthi i *heshtjes së Zotit*. Kafka akuzon në veprat e tij sistemin shoqëror burokratik antinjerëzor dhe kritikon sistemin e drejtësisë. Protagonisti i tij në romanin *Procesi* është viktimë e sistemit dhe njëkohësisht fajtor si pjesë përbërëse e aparatit burokratik. Procesi kundër tij është një organizim i përsosur veprimesh e njerëzish që arrestojnë njerëz të pafajshëm, sajojnë procese të pakuptimta.

Ndërsa në anën tjetër Albert Kamy lidh në mënyrë të pazgjidhshme jetën e tij personale, me peripecitë kolektive, në emër të njeriut, të jetës së tij absurde në tokë në kërkim të së vërtetës dhe të lumturisë. Vepra e Kamy-së nis me problematikat ekzistenciale të absurdit: ai pohon se njeriu është i vetëm, i rrethuar nga një gjendje shtetërrëthimi të përjetshëm: varfëria, dhimbja, padrejtësia, dhuna krijojnë përreth tij një shkretëtirë të pajustificuar. Për të shmangur dëshpërimin njeriu duhet të pranojë me kthjelltësi këtë situatë dhe me vetëdije të plotë duhet të luftojë për të afirmuar vetveten dhe “madhështinë e pamëshirshme të jetës”.

Fjalët kyçe: *Roman, Kafka, Kamy, Procesi, I huaji.*

1. Hyrje

Në Europën Qendrore, në fund të shekullit XIX dhe fillim të XX, u zhvillua një traditë kulturore e nisur nga Floberi dhe Dostojevski dhe e vazhduar nga Prusti, Xhojsi e Tomas Mani. Në gjurmët e të parëve dhe përkrah grupit të dytë, Franc Kafka konsiderohet si një nga mjeshttrat e mëdhenj të romanit bashkëkohor. Proza evropiane arriti majat e shprehjes artistike në atë masë që mund të konsiderohet *klasike* edhe falë veprës simbolike, aktuale dhe sugestionuese të Kafkës. Në veprat e Kafkës hasen tema të larmishme dhe të rëndësishme të tilla si moskomunikimi, moskuptimi, papërshtatshmëria me ambientin rrethues dhe pamundësia për të qenë pjesë aktive e botës.

Ndërsa për ta kuptuar Kamy-në në themel, duket kaluar nga letërsitë greke dhe romake, nëpër historinë e feve dhe të filozofive, duke mbërritur te shkrimtarët dhe mendimtarët klasikë dhe modernë. Kamy i lindur në Algjeri nga baba francez e nënë spanjolle, tek ai u gërshtuan në mënyrë perfekt fantazia arabe, intelektu latin dhe eleganca hispanike. Kjo e bën që romani i tij *I huaji* të jetë një gërshtim i jetës private me kohën kur është shkruar romani, pra koha ndërmjet dy luftërave botërore.

2. Romani *Procesi*

Në pensionin e punonjësit të bankës, Jozef K., njeri i mirë dhe i ndershëm, shkojnë dy policë me një urdhr paraqitjeje nga gjykata për një krim të papërcaktuar. Ngjarjet zhvillohen në pension, në bankë, në kafene, në katedrale (Kafka, 2005, 13). Pak personazhe kanë emra, shumica janë personazhe simbolike e konvencionale pa emra (gjyqtari, hetuesi, avokati, komisar, xhaxhai, prifti, piktori, xhelatët, rojet). K., i drejtohet një avokati i cili i shpjegon se këto procese zgjidhen me korrupsion dhe intriga.

K. nuk resht së provuari rrugët ligjore edhe pse kontakti me organizatën misterioze dhe gjigante e bën të ndjehet gjithmonë e më shumë i brishtë dhe i pambrojtur. Gjyqi është një institucion i plotfuqishëm dhe i kudondodhur (në katet e fundit dhe në papafingot e pallateve). K. e kupton se nuk mund t'i shpëtojë procesit, as të hyjë në mbretërinë superiore të ligjit dhe as ta kuptojë doktrinën e tij. Kafka dominohej nga një *parim autoriteti* shtypës, një lloj nënshtrimi jo kritik ndaj një autoriteti të pidentifikuar. Nga ana tjetër ai kishte edhe një *ndjenjë të lartë përgjegjësie* ndaj babait që duket qartë në *Letër babait*. Ideja e fajësisë së përgjithshme përshkon romanin *Procesi*. Ndëshkimi, shtypja, *ndjenja e fajit* bëhen gjendja absolute e njeriut dhe alegori e pakuptimësisë së jetës (Morel, 1998, 20).

Në një shoqëri të pakuptueshme, absurde dhe persekutuese, protagonistët e romaneve i nënshtrohen asaj dhe duhet të shlyejnë një faj, i cili ndonjëherë është i panjohur edhe për ata vetë. Për Kafkën *gjyqi* është drejtësia më të lartë, forca vepruese e ligjit suprem njerëzor, dënimi për veprimet e gabuara të kryera në jetë. Ndjenja e drejtësisë supreme dhe të paparashikueshme shfaqet te *Procesi*: Jozef K., nuk u bë i vetëdijshëm për pamjaftueshmërinë e tij, nuk pranoi t'i nënshtrohej me përulësi vullnetit të diçkaje “të vërtetë” dhe të “pamatshme” me të, sepse shpresonte se pafajësia nuk mund të ndëshkohet. Në një sistem me vlera të përmbysura, drejtësia

funksionon sipas ligjit të më të fortit, protesta e rëndon fajin: *lloji i fajit varet nga ç'mendojnë gjykatësit dhe jo nga çfarë ka bërë i gjykuari*.

3. Romani *I huaji*

I huaji përfaqëson veprën ku Kamy paraqet qëndrimet, pozicionet, premiset e mendimit të tij në lidhje me fatin e njeriut. Sipas tij njeriu i detyruar të jetojë në një univers irracional dhe absurd, duhet të përballojë me kthjelltësi një ekzistencë pa shpresë e pa kuptim. Ai përqendrohet tek njohja e absurdit dhe tek analiza e kthjellët e irracionalitetit të gjendjes njerëzore. Tek romani *I huaji*, krimi kryhet në momentin kur prishet harmonia mes njeriu dhe botës. Për herë të parë trupi nuk reagoi ndaj dritës, djelli e frustroi lëkurën në vend që ta përkëdhelte, drita i verboi sytë dhe ekuilibri ekzistencial u pështjellua nga prishja e harmonisë mes njeriut dhe natyrës.

Romani ndahet në dy pjesë: pjesa e parë ndahet në gjashtë kapituj, ndërsa pjesa e dytë në pesë kapituj. Pjesa e parë, në formë ditar, është “e mbrapshta” e jetës së protagonistit, banaliteti i përditshëm që konsumon ekzistencën. Pjesa e dytë, historia e protagonistit Merso që pas një viti analizon të shkuarën, është “e mbara”: Merso-ja pranon figurën e rreme të personalitetit të tij që të tjerët - gjyqtarët, dëshmitarët, opinionin publik, kanë krijuar për atë, dhe kupton, në burg, dimensionin e tij ekzistencial (Kamy, 2011, 111).

Romani i shkruar në vetë të parë, me një teknikë që qëndron mes ditarit dhe monologut të brendshëm, tregon një copëz të ekzistencës së protagonistit i cili identifikohet me narratorin. Në roman del lidhja mes pozicionit ideologjik të shkrimtarit dhe stilit: fjali të shkurtra, të shkëputura, regjistrime të përshtypjeve të menjëhershme, të çasteve të veçanta, mes të cilave nuk del në pah raporti shkak-pasojë, por vetëm ai kronologjik; sintaksa nuk është komplekse.

Një strukturë e gjerë dhe komplekse sintaksore do të tejkalonte absurdin, përfshirjen e ndjesive dhe të çasteve të izoluar në një rrjetë të vazhdueshme e koherente, mbivlerësim i hollësive të parëndësishme në një kuptim total. Kamyja përshkruan me hollësi në faqet e fundit të pjesës së parë të librit të gjithë mekanizmin dhe rrethanat që e kanë çuar Mersonë të shtypë këmbëzën. Mesazhi i historisë së njeriut “të dënuar padrejtësisht” për një krim që e ka kryer realisht dhe më pas detyrimi moral i të gjithë ideologjisë së Kamysë mund të përmbledhet në fjalinë: “duhet të jemi të sinqertë dhe mos të gjykojmë” (Pingaud, 1992, 53).

4. Krahësimi i romaneve *Procesi* dhe *I huaji*

Të dy romanet kanë nga një protagonist kryesor të romanit, te *Procesi* është Jozef K., ndërsa te *I huaji* është Merso, të dy protagonistët janë nëpunës shtetëror, që punojnë në bankë. Të dy romanet shkruhen në mes dy luftërave botërore, Kafka fillon të shkruajë *Procesin* pas vitit 1914, ndërsa botohet në vitin 1925 si vepër postmortum. Ndërsa romanin *I huaji* Kamy e kishte filluar ta shkruajë në vitin 1937, kohë kur në Evropë gjegjësisht në Spanjë kishte filluar Lufta civile nën udhëheqjen e mbretit Franko dhe del në botim në korrik të vitit 1942, kohë kur ishte kulmi i Luftës së Dytë Botërore.

Në analizën e *Procesit*, vihet re një e vërtetë tronditëse e realitetit me njeriun e thjeshtë brenda dhe sistemet që ndryshojnë dhe e shikojnë këtë të fundit si një pengesë apo një të mirë për to.

Kafka parapëlqen një të vërtetë të skajshme ku sheqerosjet artistike nuk janë me vlere në veprën e tij. Personazhi përgjithësisht është njeriu i rëndomtë, jo heroi që bën diferencën. Në personazhin e *Procesit* Jozef K., sistemi gjigant i pushtetit i bën grafikun e jetës pa e shpjeguar se për se e trajton ashtu deri në vendimin për ta vrarë pa i dhënë shpjegim (Kafka, 2005, 68). Nga ana tjetër kjo mund të analizohet dhe në të kundërt, vetë Jozef K., nuk ka aftësinë për të kuptuar sistemin megjithëse përpiket që të kuptojë diçka, përsëri është i mbytur në paqartësi.

Jozef K., mund të shikohet në disa drejtime të tjera ai nuk është vetëm njeri, por dhe ligjësi skolasitike e cila në një periudhë të caktuar humbet ekzistencën e saj pasi një ligj tjetër e nxjerr atë të pavlerë. Jozef K., në disa rrethana që i krijohen, kryen marrëdhënie intime me një vajze pa modalitet klasik të njohjes, bisedës ose ndjesisë emocionale dhe kurse ç'farë veprimesh paraprijëse për të kaluar në marrëdhënie seksuale, por e realizon atë në një formë apriori sikur të mos ketë vend për kushtëzime dhe justifikime (Morel, 1998, 99).

Por veprimi i Jozef K., mund të shihet dhe si një protestë e Kafkës me dy elementë. I pari sistemi (qoftë teologjik, politik, tradicional, etj.) që vepron në mënyrë injoruese ndaj individit dhe ky i fundit i përgjigjet atij me të njëjtën monedhë duke krijuar kështu plotësimin instiktiv ndaj dëshirave rastësore. Kjo vepër dhe po ashtu vepra në tërësi e Kafkës me të drejtë është një orteq që sa më shumë thellohesh, aq më i madh bëhet deri sa ortequ është vetë globi që banojmë. Kafka nuk është dekadent, ai bën një portret të gjërave por nuk mundohet të rrënoje, të mohojë apo të zgjedhë mjete për të asgjësuar, ai thjesht paraqet ftohtësisht acarin e absurditetit.

Vdekja është një zgjedhje e natyrshme e tij por jo me ekzaltim e për mundësinë e ndreqjes por duke çliruar pamundësinë përballë natyrës absurde që e rrethon. Kafka në vetvete është një protestues i madh; është vetë protesta. Ai nuk krijon arsyetime fatale por paraqet botën dhe në këtë drejtim protesta e tij nuk ka hierarki drejtuese, ajo lind apriori për të gjithë që nga momenti i zgjimit në absurd gjithashtu ajo nuk ka mjete lufte përveç reflektimit mbi situatën.

Siç dihet, punonjësi i bankës Jozef K., një mëngjes arrestohet befás nga dy policë, pa bërë asnjë faj. Nis procesi kundër qytetarit, por një proces “ala Kafkë”. I arrestuari mund të vazhdojë punën edhe në bankë si një punonjës i rëndësishëm, veçse diku, dikur duhet të paraqitet para organëve të rendit si i arrestuar! Diagrama e personazhit është shumë e thjeshtë në dukje. Pas disa muajsh ankthi e pritjeje, Jozef K., e marrin po ata policë, që e kishim marrë që në fillim, e shoqërojnë deri në fundin e një rruge dhe atje e vrasin si qen, madje jo me plumb, por me një thikë, duke ia përdredhur disa herë në gjoks (Kafka, 2005, 185).

I huaji është roman më kompleks, ka elemente të romanit të aksionit dhe të romanit psikologjik. Një nëpunës i rëndomtë merr një telegram nga shtëpia e pleqëve me të cilin njoftohet për vdekjen e nënës së tij, të cilën e kishte vendosur atje para tre vjetësh. Merr pjesë në mënyrë bizare në varrimin e nënës. Të nesërmen në plazh e takon një kolege të dikurshme.

Në mbrëmje shkojnë në kinema dhe kalojnë natën së bashku. Pas dy javësh fciu i tij Raymond e fton për të kaluar një uikend në bregdet, atje ai ngatërrohet me dy arabë, Mersoja duke u munduar t'i qetësojë ata, në rrethana të çuditshme, padashur e vret një arab.

Pjesa e dytë e romanit fillon me marrjen në pyetje të Mersosë nga ana e policisë, ku shumë herë e morën në pyetje, që ishin hetime për identitetin dhe nuk zgjatnin shumë. Në fillim dukej

se çështja nuk i interesonte askujt në komisariat, por pas tetë ditëve procedurën e mori në dorë hetuesi i cili në fillim e pyeti vetëm emrin, adresën, profesionin, ditën dhe vendin e lindjes. Të nesërmen e viziton një avokat i cili tregon se kishte studiuar dosjen dhe se çështja e tij ishte delikate (Kamy, 2008, 75).

Procesi gjyqësor fillon me marrjen në pyetje të Mersosë, ku përsëri fillojnë me pyetjet për identitetin, pastaj kryetari i trupit gjykues filloi të lexojë akuzën, duke lexuar me hollësi çdo detaj të deklaratës së tij. Ai bëri disa pyetje si: *“Më pyeti përse e kisha futur mamanë në azil. Iu përgjigja se s’kisha të holla të paguar një njeri që të kujdesej për të”* (Kamy, 2008, 100). Pastaj vazhdoi prokurori me pyetjet e tij dhe dëshironte të dinte se pse Merso ishte kthyer tek burimi me qëllim që ta vriste arabin, ku Merso thotë: *“Jo i thashë. Atëherë përse ishte i armatosur dhe kthehej pikërisht tek ky vend. I thashë se ndodhi rastësisht”* (Visoka, 2007, 57).

Pas kësaj Mersoja ngrihet në këmbë dhe e merr fjalën që t’i kundërpërgjigjet prokurorit se gjithçka ndodhi për shkak të diellit dhe tërë sallën e kapluan të qeshurat. Kurse avokati mendohej ta mbrojtë dhe duke pranuar se ka vrarë njeri, përsëri nuk ishte një njeri kriminel, kërkonte që të mos i shqiptohet dënim me vdekje një punonjësi të ndershëm që gaboi në një çast hutimi dhe kërkonte rrethana lehtësuese për atë krim të bërë nga ana e Mersosë (Pingaud, 1992, 81).

Pas mbarimit të fjalimit të avokatit, trupi gjykues e pezullon seancën dhe tërhiqet, ndërsa më vonë kthehet në sallë duke lexuar një seri të akuzave si “fajtor për vrasje”...“paramendim”...“rrethana lehtësuese”. Pas kësaj trupi gjykues u tërhoq, ndërsa avokati i tha Mersosë do të kalojë vetëm me disa vjet burg. Pas një kohe prej tre orësh, cingërroi një zile dhe kryetari i trupit gjykues e lexoi vendimin ku shkruante se: *“dënohej me prerjen e kokës në mes të një sheshi në emër të popullit francez”* (Visoka, 2007, 122).

5. Përfundimi

Në letërsi, natyrisht nuk ka formula, veçse lëvizje nga një qerthull në tjetrin më të ri. Prandaj Kafka është dhe fillim dhe fund. Formula “matematike” e tij, në letërsi përshkroi portretin e kohës, të kohërave në agoni, luftë, ankth, nënshtrim, trishtim... e përsëri nga e para... e përsëri ciklike e të pafundme. Por, vullnetet e mëdha gjithnjë kanë dëshirën e përrurimeve të reja. Ai sendërtoi shqetësimet njerëzore me veprimin e kundërt të pafajësisë, themeloi një kulturë të re dhe kurrë nuk vuri pikë për të përruruar fundin, por lëvizjen për një hop të ri si fillim.

Kafka dhe vuante deri në mosbesim nga ato që shkruante pena e tij. Ai vërejti dinjitetin njerëzor të shkelej e të përtbaltej, sepse gënjeshtria dhe hipokrizia u ngrit në moral, sepse njeriu ka pushuar së respektuari veten që kur humbi respektin për tjetrin, sepse natyra njerëzore është e ndryshueshme, e paqëndrueshme si balta e pluhuri, që dhe kur lidhen, fillon të zhduki lidhjet deri te coptimi i *vetes njerëzore*. Kafka e shtrin personalitetin e tij midis skajeve të besimit dhe të dyshimit. Ai foli më tepër pas vdekjes dhe vjen e kristalizohet si dhimbje edhe për faktin se krijimet e mëdha, fillimisht nuk priten mirë.

Fenomeni me të cilin është marrë vazhdimisht Kafka, i trazon njerëzit ende sot (Morel, 1998, 56). Këto janë përvoja të modernes, që vazhdojnë deri sot dhe të cilat një autor si Kafka i ka paraqitur në mënyrë të shkëlqyer dhe ekzemplare. Modernia gjendet në identitetin kompleks të

Kafkës i cili është gjithashtu një fenomen i modernes. “Kafka ishte hebre, Kafka ishte avokat, Kafka ishte shkrimtar. Kafka vinte nga Praga, ai ishte çek dhe gjerman. Dhe të gjesh në këtë kompleksitet identitetesh të ndryshme atë Kafkë që flet me fjalë të qarta, do të mbetet me sa duket gjithnjë problem” (Morel, 1998, 74).

Me të drejtë, ndoshta të gjithë lexuesit në botë pyesin, pse, pse? Si është e mundur të vritet kështu njeriu i pafajshëm?! Ai s’kishte kryer asnjë krim, asnjë shkelje, madje që nëpunës i nderuar, ai nuk u ballafaqua asnjëherë me ligjin, nuk dëgjoi asnjë akuzë, nuk e thirrën në asnjë gjyq, nuk i ofruan as dëshmitarë, as hetues. Ndaj tij, vetëm se kish filluar një proces...Ky që dhe fundi i tij. Mos kemi të bëjmë me faktin hipotetik se çdo qytetar, nëpunës është i rrezikuar e vazhdimisht duhet të jetojë në ankth e në frikën e një goditjeje sidomos nga shteti?

I huaji ka qenë dhe mbetet njëri ndër romanet më të veçanta të Kamy-së, dhe ky roman përfronte me romanin bihejviorist amerikan, por studiuesit e Kamy-së apo siç njihen *kamyzienët* pohojnë se *I huaji* shënon një kthesë në historinë e romanit, dhe ndikimin e tij në rrymën e ardhshme letrare të letërsisë franceze të shekullit XX që njihet me emrin *Romani i ri* apo *Nouveau roman*. Duke analizuar dhe kur thellohem në veprat e Kamy-së aty e gjejmë një trajtim të shkëlqyer të padrejtësisë nga ky shkrimtar, i cili me përvojën e tij nga kjo veti na solli vepra të shkruara ku na paraqet padrejtësinë si një veti e cila qysh në kohën kur ai jetonte dhe e cila na ndjek deri në ditët e sotme.

Ai është autori që ka shkruar çdo roman me një stil të ndryshëm gjithë sa herë: thjeshtësi tek *I huaji*, virtuoizitet te *Rënia*, lirizëm te *Njeriu i parë*...pohon vetë Kamy-ja në *Fletoret* e tij. Në romanin *I huaji* kur bëjmë një krahasim të jetës së Kamy-së me atë të Merso-së gjejmë shumë pika të përbashkëta, siç janë: Kamy-së iu desh t’i ndërpresë studimet për një vit, gjithashtu Merso-ja i ndërpret studimet. Pastaj Kamy ka mbetur pa baba qysh i vogël, gjithashtu edhe Merso i cili e ruan një kujtim për babanë e tij.

Sa për idetë e tij politike, rrjedhojë e ndjenjës së absurdit, ato shprehin mospajtimin dhe kundërshtinë ndaj totalitarizmit dhe nevojën për revoltë (Marashi, 2004, 9). Ndonëse Kamy-ja e shpallte veten më tepër si artist se filozof, ai nuk mbahet si krijues formash. Në të vërtetë, ai kërkon stilin më të vështirë që mund të bëhet, për veprat e tij, atë që i nënshtrohet tërësisht objektit. Kritikata e tij kundër dhunës vazhdon deri në vdekjen e tij, ku ai dhunën e paraqet në aspekt të dyfishtë, si terrorizëm në një anë, kurse në anën tjetër torturën e ushtrisë franceze. Kamy ishte shumë modest dhe mendjekthjellët, nuk pranonte ta quanin filozof, e thoshte se ky që keqkuptim, për dallim nga filozofët ai nuk synonte t’i robëroj me doktrina lexuesit duke i futur në një qark të vërtetash të mbyllura, por ai komunikonte përmes dy portash dhe atë të arsyes dhe ndjeshmërisë.

Referencat

- [1]. Camus, A. (2011). *L'étranger*. Paris: Gallimard.
- [2]. Chevrel, Y. (2002). *Letërsi e krahasuar*. Tiranë: Albin.
- [3]. Fraj, N. (1979). *Anatomia e kritikës*. Prishtinë: Rilindja.
- [4]. De Zepetnek, S.-T. (1998). *Comparative Literature: Theory, Method, Application*. Amsterdam: Rodopi.
- [5]. Gashi, O. (2001). *Studime interliterare*. Prishtinë: Rozafa.
- [6]. Gashi, O. (2005). *Miti dhe romantizmi evropian*. Prishtinë: PEN.
- [7]. Gashi, O. (2008). *Kufijtë e letërsisë*. Prishtinë: Rozafa.
- [8]. Guyard, M.-F. (1951). *La littérature comparée*. Paris: PUF.
- [9]. Kafka, F. (1987) *Le Procès*. Paris: Gallimard.
- [10]. Kamy, A. (2008). *I huaji*. Shkup: Vatra.
- [11]. Marashi, A. (2004). *Albert Kamy – njeriu, mendimtari, artisti*. Tetovë: Albas.
- [12]. Morel, J.-P. (1998). *Le Procès de Franc Kafka*. Paris: Gallimard.
- [13]. Pingaud, B. (1992) *L'étranger d'Albert Kamy*. Paris: Gallimard.
- [14]. Praver, S.-S. (1973). *Comparative Literature Studies, An Introduction*. London: Duckworth.
- [15]. Salihu, S. (2013). *Hyrje në letërsinë botërore*. Tetovë: USHT.
- [16]. Visoka, A. (2007). *Kamy-rrëfimi dhe idetë*. Prishtinë: SHB Faik Konica.
- [17]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*. 99-AIKD, Prishtinë: 99-AIKD.
- [18]. Visoka, A. (2016). *Shkrim dhe receptim*. Prishtinë: SHB Faik Konica.
- [19]. Wellek, R. & Warren, A. (2007). *Teoria e letërsisë*, Tiranë: Onufri.